



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/  
PROCUREMENT REVIEW BODY

Në bazë të nenit 28 të Rregullores së Punës së OSHP – së dhe në pajtim me nenin 107 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Organi Shqyrtues i Prokurimit bënë këtë :

## **SHPALLJE PUBLIKE**

### **PËR KONKURSIN E EKSPERTËVE TEKNIK**

Përmes së cilës i njoftojmë të gjithë kandidatët e interesuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit në pajtim me nenin 28 të Rregullores së Punës së OSHP-së dhe Paneleve Shqyrtuese, me qëllim të mbrojtjes së interesave të Autoriteteve Kontraktuese do të përpilojë dhe mbajë një listë të **Ekspertëve Teknik**, të kualifikuar për shqyrtim të ankesave të Operatorëve Ekonomik, të cilët do të angazhohen gjatë shqyrtimit të ankesave dhe zbatimit të aktiviteteve të Prokurimit konform kushteve të përcaktuara nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Ftohen të gjithë kandidatët e interesuar që brenda afatit të caktuar në shpallje të paraqiten me dokumentacionin përkatës në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

#### **Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët janë:**

**1. Të kenë të kryer Fakultetin e lëmime si në vijim:**

- Inxhinier të Makinerisë;
- Inxhinier të Elektroteknikës;
- Inxhinier të Teknologjisë Informativë.

**2. Të kenë tri (3) vite përvojë pune profesionale dhe sidomos në lëminë e ekspertizës;**

**3. Të jenë të paanshëm në vendosje , me ngritje të lartë profesionale dhe të kenë njohuri lidhur me zbatimin e aktiviteteve të Prokurimit;**

**4. Mos të kenë konflikt të interesit (sipas nenit 12 të Rregullores së Punës së OSHP-së dhe Paneleve Shqyrtuese).**

Kandidatët duhet t'i bashkangjesin aplikacionit këto dokumente : Çertifikatën e lindjes, diplomën e fakultetit të kryer, vërtetimin mbi përvojën e punës, vërtetimin për punën që kryen aktualisht dhe kopjen e letërnjoftimit.

Dokumentet dorëzohen në Organin Shqyrtues të Prokurimit / Zyra e Personelit ( Adresa : Rr.Garibaldi p.n ish Drejtoria e Minierave të Kishnicës 10000, Prishtinë) ose përmes e-mailit : [arta.S.berisha@rks-gov.net](mailto:arta.S.berisha@rks-gov.net).

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati nuk do të shqyrtohen fare.

Për informata shtesë mund të kontaktoni me **Zyrën e Personelit** në numrin e telefonit : **038/212-360** prej orës **08:00 – 16:00**.

**Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor ( prej datës : 29.01.2015 deri më datën : 12.02.2015 në ora 16:00.**

Pas përfundimit të përpilimit të listës së **Ekspertëve Teknik**, Organi Shqyrtues i Prokurimit, do të informojë me shkrim të gjithë kandidatët të cilët kanë konkurruar për këto pozita **“Ekspert teknik në OSHP”**.

Prishtinë,

29.01.2015